RAPORT I HOLLËSISHËM

BASHKIMI ME PËRTHITHJE I SHOQËRIVE:

BANKA CREDINS SH.A.

***si Shoqëri Përthithëse***

DHE

CREDINS LEASING SH.A

***si Shoqëri e Përthithur***

CREDINS bank

CREDINS leasing

**TABELA E PËRMBAJTJES**

I. DEKLARATA PARAPRAKE DHE QËLLIMI I BASHKIMIT ..... 3
II. FORMA LIGJORE E BASHKIMIT DHE PËRSHKRIMI I PROCEDURËS PËR BASHKIM ..... 4
III. PËRSHKRIMI I DY SHOQËRIVE TË PËRFSHIRA NË BASHKIM DHE STRUKTURA E AKSIONERËVE. ..... 7
IV. BILANCET NË MBYLLJE DHE BILANCI I CELJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE ..... 9
V. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUESHME ..... 10
VI. RAPORTI I KËMBIMIT TË AKSIONEVE ..... 10
VII. PASQYRAT FINANCIARE PAS BASHKIMIT ..... 13
VIII. TË DREJTA TË VECANTA ..... 16
IX. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE ..... 16
i. Sistemi i TI ..... 16
ii. Organigrama e Re ..... 17
iii. Plani i Biznesit dhe Pritshmëritë Ekonomike ..... 17
iv. Statuti i Ndryshuar ..... 17
v. Njoftimi dhe/ose Marrja e Pëlqimit nga Palë të Treta ..... 18
X. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT ..... 18
XI. EFEKTE MBI ORGANET DREJTUESE TË BANKËS CREDINS PAS PËRTHITHJES ..... 18
XII. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT ..... 18
XIII. LISTA E ANEKSEVE ..... 19

## I. DEKLARATA PARAPRAKE DHE QËLLIMI I BASHKIMIT

- Në datën 24.05.2013, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Banka Credins Sh.A. vendosi fillimin e procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Credins Leasing Sh.A. (shoqëria e përthithur) tek shoqëria Banka Credins Sh.A. (shoqëria përthithëse) në këmbim të aksioneve të kësaj shoqërie.
- Në datën 21.05.2015, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve të Credins Leasing Sh.A. vendosi fillimin e procesit të bashkimit me përthithje nëpërmjet kalimit të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë Credins Leasing Sh.A. (shoqëria e përthithur) tek shoqëria Banka Credins Sh.A. (shoqëria përthithëse) në këmbim të aksioneve të kësaj shoqërie.
- Në përputhje dhe zbatim të vendimeve të mësipërme, Banka Credins Sh.A. dhe shoqëria Credins Leasing Sh.A do të bashkohen nga ana ligjore dhe organizative. Për këtë qëllim Banka Credins Sh.A dhe Credins Leasing Sh.A. do të integrohen në një person juridik të vetëm ("Transakioni i Bashkimit").
- Qëllimi i këtij bashkimi është zhvillimi i mëtejshëm i aktivitetit të qirasë financiare, rritja e numrit të klientëve të dyfishtë (shitjeve të kryqëzuara), rritja e konkurueshmërisë, rendimentit dhe përfitimi i një efekti sinergjik, ulja e kostove dhe shfrytëzimi më efektiv i burimeve, përmirësimi i pozicionit në treg dhe si rezultat rritja e të ardhurave dhe fitimit për aksion.
- Bashkimi me përthithje do të krijojë një kompani me një bazë më të gjerë asetesh, një vlerë neto biznesi më të lartë që do të mundësojë një qëndrim dhe mbrojtje më të fortë ndaj risqeve të ndryshëm.
- Me një portofol më të gjerë produktesh e klientësh, me një kontroll më të fortë të shpenzimeve administrative duke përfituar edhe nga fuqia negociuese më e lartë e bankës dhe përshkak të të gjithë elementëve të përmendur më sipër, kompania pas bashkimit do të gëzojë një kapacitet rritje më të lartë se ai i dy kompanive individuale.
- Duke qënë se 97% e aksioneve të Credins Leasing Sh.A. zotërohen nga aksionerë të Bankës Credins, suksesi i bashkimit me përthithje nuk rrezikohet nga ndryshime kulturore, që në këtë rast nuk ekzistojnë, apo edhe nga perceptimi i klientelës. Përshkak të emërtimit të ngjashëm të kompanive si dhe faktit që dikur kompanitë kanë qënë një personalitet juridik, klientela është e informuar dhe "mësuar" me lidhjen e fortë mes dy kompanive prandaj nuk pritet asnjë impakt negativ në rradhët e klientelës. Mundësia e reagimit në mënyrë emocionale të klientelës ndaj bashkimit, në këtë rast, nuk ekziston.
- Skema e bashkimit është në përfitim të aksionerëve, punonjësve, kreditorëve.
- Edhe pas bashkimit me përthithje misioni dhe vizioni i bankës do të mbeten të njëjtat:
  Vizioni: "Të njihet si banka më e mirë, me shërbim të plotë, në Shqipëri, e renditur si numri një për Shqiptarët." dhe,
  Misioni: "Të ofrojë shërbim të shkëlqyer për klientelën dhe të ndërtojë një biznes me njerëz, asete dhe vlera të shkëlqyera."

- Periudha nga data e miratimit të projektit të bashkimit (nënshkrimit të marrëveshjes së bashkimit) deri në datën e regjistrimit të transaksionit të bashkimit në QKR do të jetë një periudhë tranzitore, gjatë së cilës Banka Credins dhe Credins Leasing do të marrin një sërë masash e do të plotësojnë disa kushte me qëllim përmbushjen me sukses të transaksionit të bashkimit me përthithje.

## II. FORMA LIGJORE E BASHKIMIT DHE PËRSHKRIMI I PROCEDURËS PËR BASHKIM

Bashkimi i shoqërive me përthithje nënkupton transferimin e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të Credins Leasing Sh.A (shoqëria e përthithur) në Credins Bank Sh.A (shoqëria përthithëse) në këmbim të aksioneve të bankës. Procedura që ndiqet për realizimin e bashkimit të shoqërive duhet të kalojë në dy faza kryesore procedurale, të cilat njoftohen dhe regjistrohen në QKR.

Faza e parë fillon me hartimin e një projektmarrëveshje nga përfaqësuesit ligjorë të dy shoqërive. Projektmarrëveshja midis palëve duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

a) emrat e regjistruar dhe selitë e shoqërive, që marrin pjesë në bashkim;

b) pranimi i palëve për kalimin e pasurive të shoqërisë që përthithet, në këmbim të aksioneve të shoqërisë përthithëse;

c) raporti i këmbimit të aksioneve dhe çdo shumë e pagueshme në para;

d) kushtet e ndarjes së aksioneve në shoqërinë përthithëse;

e) të drejtat, që rrjedhin nga aksionet e shoqërisë përthithëse;

f) të drejtat, që shoqëria përthithëse u njeh zotëruesve të aksioneve, kuotave apo të drejtave të veçanta të shoqërive të përthithura apo çdo mase tjetër në favor të tyre;

g) përparësitë e veçanta, që u jepen administratorëve, anëtarëve të këshillit të administrimit, këshillit mbikëqyrës apo ekspertëve kontabël të autorizuar;

h) pasojat që bashkimi do të ketë ndaj punëmarrësve e përfaqësuesve të tyre, si dhe masat e propozuara për to.

Projektmarrëveshja e mësipërme është një kontratë, e cila përmban termat përfundimtare që u propozohet aksionerëve për nënshkrim. Duke qënë se termat mund të jenë shumë teknikë dhe jo gjithmonë të thjeshta për t'u kuptuar, ligji detyron përfaqësuesit ligjorë të hartojnë këtë raport të hollësishëm i cili zbërthen dhe shpjegon projektmarrëveshjen e mësipërme në një gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme për të gjithë aksionerët e shoqërive.

Në këtë raport përshkruhen bazat ligjore dhe ekonomike të bashkimit, raporti i shkëmbimit të aksioneve apo të drejtave të vecanta, vështirësitë që janë hasur në përllogaritjen e aksioneve apo të drejtave të vecanta me kapitalin e shoqërisë së re si dhe efektin e këtij bashkimi tek punemarrësit.

Në rast se kërkohet nga të paktën një nga aksionerët e shoqërive, është e detyrueshme marrja e një ekspert i pavarur të fushës për të cërtifikuar termat e projektmarrëveshjes.

Eksperti harton një raport në të cilin shpreh vlerësimin e tij të pavarur mbi të gjitha cështjet e projektmarrëveshjes që janë të rëndësishme për pronarët e shoqërive në proces bashkimi.

Me qëllim që aksionerët të njihen me projektmarrëveshjen si dhe impaktin e saj, duhet që ajo të publikohet në faqen e internetit të shoqërive dhe të depozitohet në QKR të paktën 1 (një) muaj para datës së caktuar për mbledhjen e asamblesë që do të miratojë marrëveshjen.

Publikimi duhet të përmbajë këto dokumenta:

1. projektmarrëveshjen;
2. raportin e hollësishëm të përfaqësuesve ligjorë mbi projektmarrëveshjen;
3. pasqyrat financiare dhe ato të ecurisë së veprimtarisë të shoqërisë për të paktën tre vitet e fundit;
4. raporti i ekspertit, nësë ka;

Faza e dytë është ajo e miratimit të projektmarrëveshjes së bashkimit në asambletë e shoqërive në proces bashkimi. Asambletë e shoqërive miratojnë marrëveshjen në kushtet e kuorumit dhe shumicës së cilësuar. Në asamble duhet të marrin pjesë aksonerët që kanë më shumë se 50% të aksioneve me të drejtë vote dhe duhet të votojnë pro bashkimit dhe dokumtentave respektivë të paktën ¾ e pjesëmarrësve.

Në rastet kur projektmarrëveshja prek të drejta të vecanta të disa aksionerëve (ose klase të vecantë aksionesh) atëhere duhet duhet ti nënshtrohet miratimit të aksionerëve që preken nëpërmjet një votimi të vecantë, i cili merret me shumicën e ¾ të votave të seciles kategori aksionerësh apo aksionesh të prekur.

Procesi i bashkimit me përthithje kërkon që shoqëria përthithëse të rrisë kapitalin në mënyrë që aksionet e reja t'u shpërndahen aksionerëve të shoqërisë së përthithur. Ligji parashikon se mbi këtë lloj zmadhimi të kapitalit të Bankës Credins Sh.A. nuk zbatohen dispozitat e mëposhtme:

- ndalimi i zmadhimit derisa të kryhen pagesat e pashlyera për aksionet e nënshkruara më parë;
- të drejtat e parablerjes nga aksionarët të aksioneve të reja ( pra aksionerët ekzistues të shoqërisë përthithëse heqin dorë nga e drejta e parablerjes së kapitalit të ri në favor të aksionerë të rinj që do të vijnë nga shoqëria e përthithur).
- kushtet për nënshkrimin e kuotave/aksioneve të reja;

Pas miratimit të projektit të bashkimit në asambletë e shoqërive, përfaqësuesit ligjorë të tyre aplikojnë pranë Bankës së Shqipërisë për marrjen e miratimit paraprak, njoftojnë organet tatimore dhe të gjitha palët e treta të interesuar për bashkimin si dhe aplikojnë pranë Autoriteti i Konkurrencës për autorizimin e bashkimit.

Banka nuk mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me përthithje pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë.

Kërkesa me shkrim drejtuar BSH do të shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) vendimi i asamblesë së aksionerëve të secilës shoqëri të përfshirë në operacion për miratimin e riorganizimit të tyre nëpërmjet bashkimit me përthithje;

b) projekt-marrëveshja dhe ky raport i detajuar i operacionit të bashkimit me përthithje, të nënshkruar nga përfaqësuesit ligjorë të kompanive që marrin pjesë në bashkim.

c) raporti i ekspertëve të pavarur të licencuar të fushave të ndryshme, për të vlerësuar kushtet e projektmarrëveshjes së bashkimit (nëse ka);

d) projektstatuti i bankës pas realizimit të operacionit të bashkimit me përthithje;

e) planet strategjike dhe operative për realizimin e përthithjes, në të cilat përfshihet analiza e nevojshmërisë së përthithjes dhe parashikime të raporteve financiare për bankën përthithëse, të përgatitura në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, shkronja "e" të rregullores së BSH për licencimin e bankave;

f) struktura e re organizative me përshkrim të veçantë të punës dhe të përgjegjësive të personave me të drejta dhe përgjegjësi të veçanta si dhe numri i mundshëm i punonjësve;

h) struktura e re e aksionerëve të bankës përthithëse;

i) bilanci i bankës përthithëse dhe të dhëna të detajuara për kapitalin aksioner të vet, të përgatitura mbi baza të konsoliduara dhe të certifikuara nga një ekspert kontabël i autorizuar.

Kuadri i vlefshmërisësë bashkimit të shoqërive përmbyllet me marrjen e miratimit nga Autoriteti i Konkurrencës (AK).

Ligji parashikon se AK duhet të njoftohet brenda 30 ditësh nga data e miratimit të bashkimit në asambletë e shoqërive. Forma e njoftimit të AK do të realizohet në përputhje me Ligjin Nr.9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe akteve nën-ligjore në zbatim të tij.

Përfaqësuesit ligjorë, pas marrjes së autorizimit për bashkim nga AK dhe miratimit paraprak nga Banka e Shqipërisë njoftojnë bashkimin për regjistrim në QKR. Së bashku me marrëveshjen e miratuar do të botohet edhe vendimi për zmadhimin e kapitalit, procesverbali i mbledhjes së asamblesë.

Vetëm pas këtij njoftimi në QKR mund të vijohet me zbatimin e :

1. transferimin tek shoqëria perthithëse e të gjithë aseteve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur;
2. kalimin e aksioneve të shoqërisë përthithëse në favor të aksionerëve të shoqërisë së përthithur.
3. ç'regjistrimin e shoqërisë së përthithur në QKR (pas regjistrimit të vendimit të asambleve në QKR, shoqëria e përthithur konsiderohet e prishur).

Në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të aksionerëve dhe kreditorëve të shoqërisë së përthithur, ligji parashikon dispozita të vecanta në favor të respektimit të së drejtave të tyre. Kështu, aksionerët të cilët nuk kanë votuar pro marrëveshjes së bashkimit kanë të drejtë ligjore që brenda 60 ditësh nga publikimi në QKR të vendimit të asamblesë t'i kërkojnë shoqërisë përthithëse blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre me vlerë tregu .

Kreditorët nga ana tjetër, kanë te drejtë që brenda 6 muajsh nga publikimi i vendimit në QKR të paraqesin me shkrim titullin dhe vlerën e pretendimeve dhe të kërkojnë garanci të mjaftueshme nga shoqëria përthithëse për kredite e tyre. Ligji konsideron garanci të mjaftueshme lëshimin e një deklarate me shkrim nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që marrin pjesë në bashkim, ku pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të veçuar deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve. Nëse kjo garanci nuk jepet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive, kreditorët mund t'i kërkojnë gjykatës të urdhërojë lëshimin e garancive të mjaftueshme apo anulimin e vendimit të bashkimit.

## III. PËRSHKRIMI I DY SHOQËRIVE TË PËRFSHIRA NË BASHKIM DHE STRUKTURA E AKSIONERËVE.

**BANKA CREDINS**

Banka Credins është licencuar më 31 Mars 2003; që atëherë është njohur si banka e parë private Shqiptare dhe qëndron në rradhët e bankave me performancë më të lartë në vend. Banka Credins, përgjatë 12 viteve të aktivitetit, është zgjeruar në mënyrë të vazhdueshme dhe dinamike në terma të klientëve, produkteve, aseteve e detyrimeve dhe sot është një Bankë Universale e cila u shërben rreth 226 mijë klientëve bizneseve dhe individë. Banka është e pranishme në të gjitha prefekturat e Rep. së Shqipërisë dhe operon nëpërmjet një rrjeti prej 53 degësh dhe agjencish, 24 prej të cilave janë në Tiranë , 9 në Durrës dhe 20 të tjera në qytete të tjera.

Ekipi i menaxherëve të lartë përbëhet nga bankierë në karrierë me eksperiencë profesionale të fituar në Shqipëri e jashtë saj, mbështetur nga kualifikime akademike të shkëlqyera.

Banka në mënyrë të vazhdueshme ka rritur pjesën e saj të tregut në terma të aseteve, kredive, depozitave e kartave dhe sot renditet e treta për nga madhësia e portofolit të kredisë dhe depozitave dhe e katërta për nga madhësia e aseteve. Pjesa më e madhe e portofolit të kredisë së bankës përbëhet nga financimet për korporatat dhe SME që së bashku arrijnë mbi 92% të portofolit të kredisë. Banka Credins ka rezultuar me përfitueshmëri që në vitin e dytë të aktivitetit dhe ka njohur një normë rritje vjetore të përbërë (CAGR) prej rreth 21.1% përgjatë periudhës 2007-2014 pavarësisht mjedisit financiar ndërkombëtar të pafavorshëm.

Strategjia e zgjedhur e bankës për vitet 2015-2017, " Ndërto në mënyrë selektive dhe të menaxho të ardhurat/fitimin" do të orientojë bankën drejt segmenteve jo-korporatë dhe gjetjes së pjesëve/segmenteve të reja të tregut të cilat, pavarësisht nga madhësia, mund të sigurojnë një marzh të kënaqshëm fitimi.










Banka Credins është e licencuar nga Banka e Shqipërisë për ushtrimin e aktitvitetit të qerasë financiare por aktualisht nuk e shet këtë produkt në rradhët e klientëve të saj dhe portofoli i mbetur leasing ka një vlerë të papërfillshme e pritet të amortizohet plotësisht brenda pak kohësh.

**CREDINS LEASING**

Credins Leasing Sh.A. është vazhdimësi e institutit financiar jo-bankar "Credins Sh.A."; vetëm gjatë vitit 2009 është bërë ndryshimi i emrit në Credins Leasing Sh.A. Shoqëria ka marrë licencën për ushtrimin e aktivitetit

të qerasë financiare në vitin 2007 dhe që atëhere ky aktivitet ka njohur rritje të vazhdueshme. Klima e aktivitetit të qerasë financiare ka njohur zhvillime dhe hapa pozitivë vecanërisht pas daljes së ligjit për qeranë financiare.

Aktiviteti i Credins Leasing Sh.A është i përqëndruar tërësisht në financimet leasing dhe ka vetëm një degë e cila operon në Tiranë. Fokus kryesor i financimeve janë automjetet, makineritë e pajisjet. Një pjesë e madhe e klientëve vijnë nëpërmjet koncesionarëve të tregtimit të automjeteve me të cilët Credins Leasing ka një bashkëpunim të ngushtë.

Në saj të shfrytëzimit optimal të fondeve të ardhura nga burimet e kapitalit dhe huave, Credins Leasing ,sipas të dhënave të Dhjetor 2014, zotëron 12% të tregut në bazë shumës së portofolit leasing outstanding dhe 27% tregut në bazë të numrit të autoveturave të financuara.

Klientë të Credins Leasing janë si individet ashtu edhe bizneset SME. Volumin më të madh e zenë bizneset të cilët përbëjnë 90 % të portofolit total.

Duke qënë pjesë e kreditimit nga EBRD, Credins Leasing mban në kujdes të vazhdueshëm treguesit e përcaktuar në këtë marrëveshje.










## STRUKTURA E AKSIONERËVE TË DY SHOQËRIVE

Në datën 30 Qershor 2015, 97% e aksioneve të Credins Leasing Sh.A. zotërohen nga aksionerë të Bankës Credins Sh.A. Ky fakt lehtëson dhë përshpejton procesin e vendimarrjes lidhur me bashkimin me përthithje të shoqërive.

| Aksionerë | Banka Credins Sh.A | Credins Leasing Sh.A. | |
|---|---|---|---|
| Renis Tërshana | 26.393% | 49.000% | 97% |
| Aleksandër Pilo | 18.884% | 25.000% | |
| Monika Milo | 4.373% | 5.000% | |
| Arjana Santo | 4.185% | 3.333% | |
| Egi Santo | 1.444% | 3.333% | |
| Emi Santo | 1.444% | 3.333% | |
| Maltin Korkuti | 3.226% | 3.000% | |
| Neritan Dojaka | 0.539% | 2.000% | |
| Gjergj Bushati | 0.138% | 1.000% | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Pandeli Garo | 0.475% | 2.000% | |
| Albens Bushati | | 0.667% | 3% |
| Aida Bushati | | 0.667% | |
| Veneranda Bushati | | 0.667% | |
| Ervin Bushati | | 1.000% | |
| Kostaq Milo | 0.996% | | |
| Vjollca Bushati | 0.138% | | |
| Fadil Allajbeu | 1.084% | | |
| Andon Daka | 0.951% | | |
| Leonat Koco | 0.501% | | |
| Jorgjia Balli | 0.672% | | |
| Ilirjan Bushati | 1.008% | | |
| Fuad Haxhiymeri | 4.045% | | |
| Unioni SHKK | 3.472% | | |
| B.F.S.E Holding B.V | 18.306% | | |
| SIFEM AG | 2.615% | | |
| Edmond Rexho | 0.951% | | |
| Elisabeta dhe Artur Hysi | 2.258% | | |
| Mirela Ndini | 0.951% | | |
| EDRO Sh.p.k | 0.951% | | |
| | **100.00%** | **100.00%** | |

## IV. BILANCET NË MBYLLJE DHE BILANCI I CELJES SË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE

Bashkimi me përthithje do të bazohet në pasqyrat financiare të Bankës Credins dhe Credins Leasing të datës 30 Qershor 2015 (**Data e Fundit Kontabël**).

**Data e Mbylljes** do të jetë data e miratimit të marrëveshjes së bashkimit me përthithje.

**Data e Ekzekutimit** do të jetë data e regjistrimit të bashkimit me përthithje të shoqërive pranë Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit.

**Bilanci i Celjes** së Shoqërisë Përthithëse (Bankës Credins) do të bazohet në bilancin e konsoliduar të Datës së Fundit Kontabël të të dy shoqërive përpara përthithjes. Cdo ndryshim, saktësim dhe korrigjim i mundshëm i Bilancit të Celjes i realizuar mes Datës së Fundit Kontabël dhe Datës së Mbylljes së bashkimit me përthithje duhet të raportohet dhe miratohet nga asambletë e aksionerëve të të dy shoqërive.

Në rast se Data e Ekzekutimit (regjistrimi i bashkimit në QKR) do të jetë më e vonshme se 31.12.2015 atëhere Data e Fundit Kontabël do të konsiderohet 31.12.2015 dhe do të duhet të reflektohen të gjitha ndryshimet në këtë raport dhe Bilancin e Celjes së Shoqërisë Përthithëse.

## V. AKTIVET DHE PASIVET E TRANSFERUESHME

Në bazë të nenit 215, pika1 e ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë së përthithur Credins Leasing Sh.A, sipas Bilancit të Datës së Fundit Kontabël, do të transferohen tek shoqëria përthithëse, Banka Credins Sh.a., në këmbim të aksioneve të kësaj të fundit.

Aktivet dhe pasivet e transferuara janë ato që përcaktohen në Bilancin Kontabël të datës 30.06.2015 si dhe cdo ndryshim i ndodhur në librat kontabël nga data e fundit kontabël deri në datën e mbylljes së bashkimit me përthithje. Përfshijnë cdo të drejtë dhe detyrim të njohur si të tillë në pasqyrat financiare, bazën e të dhënave të klientëve, listën e konflikeve apo procesve gjyqësore të pazgjidhura në datën e ekzekutimit të mbylljes, dhe cdo marrëdhënie tjetër kontraktore.

Aktivet dhe detyrimet tatimore të Credins Leasing (shoqëria e përthithur), sic rezultojnë në pasqyrat financiare të datës së fundit kontabël, do ti transferohen Bankës Credins (shoqëri përthithëse) si të gjitha llojet e tjera të aktiveve dhe detyrimeve.

Me transferimin e aktiveve dhe detyrimeve, Banka Credins do të marrë në posedim të gjithë evidencat, librat, korrespondencat, regjistrimet, marrëveshjet dhe dokumenta të tjerë për të provuar ekzistencën e të drejtave dhe detyrimeve që transferohen. Vetëkuptohet se me tranferimin e të gjitha të drejtave, aktiveve dhe detyrimeve të shoqërisë së përthithur tek shoqëria përthithëse, kjo e fundit do të gëzojë të drejtat për të ngritur pretendime ligjore ndaj këtyre aktiveve si dhe do të mbart detyrimin për t'u përgjigjur ndaj pretendimeve që mund të ngrenë palë të treta për detyrime të shoqërisë së përthithur .

Për aktive/detyrime të caktuara për transferimin e të cilave mund të nevojitet miratimi i një pale të tretë, do të merret paraprakisht ky miratim.

Për pasuritë e paluajtshme, Banka Credins do të bëjë regjistrimin pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në përputhje me legjislacioinin në fuqi.

Të drejta dhe detyrimet e Bankës Credins Sh.A. dhe Credins Leasing Sh.A. kundrejt njëri-tjetrit shuhen në Bilancin e Celjes së Shoqërisë Përthithëse (të tilla janë depozitat Credins Leasing pranë Bankës Credins, financimet e Credins Leasing nga Banka Credins).

Marrëdhënie të caktuara kontraktuale te shoqërisë Credins Leasing SH.A me palë të treta (të tilla si kontrata shërbimesh të ndryshme), gjithnjë nëse konstatohet së nuk do ti shërbejnë Bankës Credins pas bashkimit me përthihtje, mund të vendoset të zgjidhen para ose pas datës së regjistrimit të bashkimit me përthithje, duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe parashikimet e këtyre kontratave për zgjidhjen e tyre.

## VI. RAPORTI I KËMBIMIT TË AKSIONEVE

Raporti i këmbimit do të përcaktojë numrin e aksioneve të reja do të duhet të emetohen nga Banka.

Në përputhje me natyrën e transaksionit, mungesës së të dhënave të besueshmë të riskut të tregut të kapitaleve në Shqipëri dhe mungesës së referencave të besueshme e të sakta për transaksione të ngjashme në treg, metoda më e përshtatshme për kalkulimin e raportit të këmbimit të aksioneve të shoqërive të përfshira në bashkim është metoda e Vlerës Neto të Aseteve (Vlerë Kontabël e Aksioneve).

Për kalkulimin e raportit të këmbimit janë përdorur të dhënat e Pasqyrave Financiare IFRS të 30 Qershor 2015.

**Metoda e Vlerës Neto të Aseteve (NAV-Book Value)**

Metoda e Vlerës Neto të Aseteve është metoda më thjeshtë e zbatueshme për vlerësimin e bizneseve dhe raportit të këmbimit të aksioneve. Nuk është gjë tjetër vecse vlera kontabël e kapitalit të shoqërive ose ndryshe vlera kontabël e bizneseve. Raporti i këmbimit të aksioneve përcaktohet nga madhësia e përftuar nga pjestimi i vlerave kontabël të aksioneve të dy shoqërive.

NAV-Book Value për Bankën Credins dhe Credins Leasing paraqitet nëpërmjet tabelës së mëposhtme:

| | **Credins Bank** | **Credins Leasing** |
|---|---|---|
| Total Asete | 144,197,988,649 | 1,591,180,265 |
| Total Detyrime | 133,073,313,782 | 610,810,663 |
| Asete Neto (Kapital) | 11,124,674,866 | 980,369,602 |
| Nr. AZ të nënshkruara | 55,358,165 | 7,916,569 |
| **Vlera Kontabël/AZ** | **200.96** | **123.84** |
| **Raporti i Këmbimit** | | **1.622754** |

Raporti i këmbimit, sipas kalkulimeve të kësaj metode rezulton **0.616236 : 1** [0.616236 AZ të CR Bank për cdo 1 AZ CR Leasing] ose i shprehur ndryshme **1 : 1.622754** [Cdo 1 AZ CR Bank do të këmbehet me 1.622754 AZ CR Leasing].

Me këtë raport këmbimi, Banka Credins do të duhet të emetojë **4,878,471** aksione të reja të zakonshme (pas korrigjimit për aksionet jo të plota prej 5.25) për t'i këmbyer me 7,916,569 aksionet e zakonshme të Credins Leasing. Vlera kontabël e një aksioni të shoqërisë përthithëse (Bankës Credins) pas bashkimit do të ngelet e pandryshuar, në nivelin 200.96 Lekë. Kjo normë këmbimi siguron ruajtjen e vlerës së investimit të cdo aksioneri të bankës dhe shoqërisë së leasingut si para dhe pas bashkimit.

| | **Credins Bank** | **Credins Leasing** | **Credins Bank pas përthithjes** |
|---|---|---|---|
| Asete Neto (Kapital) Lekë | 11,124,674,866 | 980,369,602 | 12,105,043,809 |
| Nr. AZ të nënshkruara | 55,358,165 | 7,916,569 | 60,236,636 |
| **Vlera Kontabël/AZ** Lekë | **200.96** | **123.84** | **200.96** |

Pavarësisht raportit të këmbimit, kapitali i ri i bankës (shoqërisë së përthithur) do të jetë sa shuma totale e kapitaleve të dy shoqërive ndërsa elementët përbërës të tij do të përcaktohen nga raporti i këmbimit. Raporti i këmbimit të aksioneve përcakton se si do të shpërndahet vlera e kapitalit të shoqërisë së përthithur (CR Leasing) në elementët përbërës të kapitalit të bankës. Përvec dy zërave kontabël " kapital i nënshkruar" dhe "prim aksionesh", asnjë element tjetër i pasqyrave financiare nuk ndikohet nga vlera e raportit të këmbimit.

Struktura e Aksionerëve nëse aplikuar raporti i këmbimit 1: 1.622754 (sipas metodës NAV) do të paraqitej si më poshtë:

| Aksionerët | Banka Credins Nr.AZ | Banka Credins % | Credins Leasing Nr.AZ | Credins Leasing % | Nr AZ të Reja | Credins Bank pas përthithjes Nr AZ | Credins Bank pas përthithjes % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Renis Tërshana | 14,610,546 | 26.393% | 3,879,118 | 49.000% | 2,390,452.00 | 17,000,998 | 28.224% |
| Aleksandër Pilo | 10,453,749 | 18.884% | 1,979,143 | 25.000% | 1,219,619.00 | 11,673,368 | 19.379% |
| Monika Milo | 2,420,831 | 4.373% | 395,829 | 5.000% | 243,924.00 | 2,664,755 | 4.424% |
| Arjana Santo | 2,316,520 | 4.185% | 263,886 | 3.333% | 162,616.00 | 2,479,136 | 4.116% |
| Egi Santo | 799,105 | 1.444% | 263,886 | 3.333% | 162,616.00 | 961,721 | 1.597% |
| Emi Santo | 799,105 | 1.444% | 263,886 | 3.333% | 162,616.00 | 961,721 | 1.597% |
| Maltin Korkuti | 1,786,121 | 3.226% | 237,498 | 3.000% | 146,354.00 | 1,932,475 | 3.208% |
| Neritan Dojaka | 298,545 | 0.539% | 158,331 | 2.000% | 97,569.00 | 396,114 | 0.658% |
| Gjergj Bushati | 76,201 | 0.138% | 79,164 | 1.000% | 48,783.00 | 124,984 | 0.207% |
| Pandeli Garo | 263,224 | 0.475% | 158,331 | 2.000% | 97,569.00 | 360,793 | 0.599% |
| Albens Bushati | | | 52,777 | 0.667% | 32,523.00 | 32,523 | 0.054% |
| Aida Bushati | | | 52,777 | 0.667% | 32,523.00 | 32,523 | 0.054% |
| Veneranda Bushati | | | 52,778 | 0.667% | 32,523.00 | 32,523 | 0.054% |
| Ervin Bushati | | | 79,165 | 1.000% | 48,784.00 | 48,784 | 0.081% |
| Kostaq Milo | 551,142 | 0.996% | | | | 551,142 | 0.915% |
| Vjollca Bushati | 76,201 | 0.138% | | | | 76,201 | 0.127% |
| Fadil Allajbeu | 600,349 | 1.084% | | | | 600,349 | 0.997% |
| Andon Daka | 526,448 | 0.951% | | | | 526,448 | 0.874% |
| Leonat Koco | 277,519 | 0.501% | | | | 277,519 | 0.461% |
| Jorgjia Balli | 372,085 | 0.672% | | | | 372,085 | 0.618% |
| Ilirjan Bushati | 558,204 | 1.008% | | | | 558,204 | 0.927% |
| Fuad Haxhiymeri | 2,239,351 | 4.045% | | | | 2,239,351 | 3.718% |
| Unioni SHKK | 1,922,063 | 3.472% | | | | 1,922,063 | 3.191% |
| B.F.S.E Holding B.V | 10,133,680 | 18.306% | | | | 10,133,680 | 16.823% |
| SIFEM AG | 1,447,667 | 2.615% | | | | 1,447,667 | 2.403% |
| Edmond Rexho | 526,448 | 0.951% | | | | 526,448 | 0.874% |
| Elisabeta dhe Artur Hysi | 1,250,165 | 2.258% | | | | 1,250,165 | 2.075% |
| Mirela Ndini | 526,448 | 0.951% | | | | 526,448 | 0.874% |
| EDRO Sh.p.k | 526,448 | 0.951% | | | | 526,448 | 0.874% |
| Total | 55,358,165 | 100.00% | 7,916,569 | 100% | 4,878,471 | 60,236,636 | 100% |

CREDINS bank CREDINS leasing

## VII. PASQYRAT FINANCIARE PAS BASHKIMIT

Bilanci i Celjes së Shoqërisë Përthithëse është bilanci i konsoliduar para bashkimit me përthithje që nga data e fundit kontabël të dy shoqërive në fjalë. Pasqyrat Financiare të Celjes do të përgatiten në bazë të raportit të këmbimit të aksioneve të llogaritur sipas metodës së vlerës kontabël (NAV), 1 : 1.622754 (30.06.2015).

**Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar**
**Banka Credins Sh.A (pas bashkimit)**
**Date 30 Qershor 2015**

| | Banka Credins | Credins Leasing | Banka Credins Sh.A pas bashkimit | Rregullime konsolidimi |
|---|---|---|---|---|
| **Aktivet** | | | | |
| Mjete monetare dhe ekuivalente me to | 20,771,034,052 | 446,500,558 | 20,777,329,307 | -440,205,303 |
| Shuma të kushtëzuara me Bankën Qendrore | 11,093,424,034 | 0 | 11,093,424,034 | 0 |
| Hua dhe paradhënie bankave dhe institucioneve fin: | 1,714,665,016 | 0 | 1,352,760,300 | -361,904,716 |
| Hua,paradhënie dhe qera financiare për klientët | 84,244,668,721 | 917,659,368 | 85,161,399,936 | -928,152 |
| Letra me vlerë të vlefshme për shitje | 20,937,852,595 | 0 | 20,937,852,595 | 0 |
| Aktive afatgjata materiale | 711,873,653 | 2,457,239 | 714,317,289 | -13,603 |
| Aktive afatgjata jomateriale | 132,849,688 | 5,639,174 | 138,488,862 | 0 |
| Te drejta tatimore te shtyra | 6,573,777 | 0 | 6,573,777 | 0 |
| Te drejta tatimore korrente | 34,102,534 | 166,604,616 | 200,520,387 | -186,764 |
| Prona te riposeduara | 3,740,556,864 | 2,551,542 | 3,743,108,407 | 0 |
| Filiale | 65,205,560 | 0 | 65,205,560 | 0 |
| Aktive të tjera | 745,182,153 | 49,767,769 | 794,949,921 | 0 |
| **Totali i aktiveve** | **144,197,988,649** | **1,591,180,265** | **144,985,930,376** | **-803,238,538** |
| **Detyrimet** | | | | |
| Detyrimet ndaj bankave, etj | 2,309,335,099 | 0 | 1,869,129,796 | -440,205,303 |
| Huatë | 1,118,212,435 | 595,969,483 | 1,351,148,683 | -363,033,235 |
| Detyrime ndaj klientëve | 123,561,909,312 | 776,295 | 123,562,685,607 | 0 |
| Borxhi i varur | 4,866,360,412 | 0 | 4,866,360,412 | 0 |
| Detyrime tatimore korente | 55,919,633 | 1,753,714 | 57,673,346 | 0 |
| Detyrime të tjera | 1,118,302,046 | 5,852,385 | 1,124,155,090 | 659 |
| Provizione | 43,274,846 | 6,458,787 | 49,733,633 | 0 |
| **Totali i detyrimeve** | **133,073,313,782** | **610,810,663** | **132,880,886,567** | **-803,237,879** |
| **Kapitali** | | | | |
| Kapitali aksionar | 5,716,520,864 | 924,523,361 | 6,365,877,453 | -275,166,772 |
| Primi i aksioneve | 2,045,041,371 | 0 | 2,356,974,469 | 311,933,098 |
| Rezerva e përgjithshme | 1,437,615,068 | 8,410,022 | 1,446,025,090 | 0 |
| Rez.rivler. të letrave me vlerë të vlefshme për shitje | 44,190,577 | 0 | 44,190,577 | 0 |
| Fitime të pashpërndara | 1,881,306,987 | 47,436,219 | 1,891,976,220 | -36,766,985 |
| | **11,124,674,866** | **980,369,602** | **12,105,043,809** | **-659** |
| **Totali detyrimeve dhe kapitalit aksionar** | **144,197,988,649** | **1,591,180,265** | **144,985,930,376** | **-803,238,538** |

Në anekse të këtij raporti janë paraqitur shënimet shpjeguese për të gjithë zërat kontabël të konsoliduar.

*Konsiderata të Veçanta*

- Kapitali i shoqërisë përthithëse detajohet sipas tabelës së mëposhtme:

| Kapitali | Banka Credins sha<br>30 Qershor 2015 | Credins Leasing sha<br>30 Qershor 2015 | Veprime konsolidimi<br>30 Qershor 2015 | Banka Credins e konsoliduar<br>30 Qershor 2015 |
|---|---|---|---|---|
| Kapital i paguar | 5,716,520.86 | 924,523.36 | (311,933.76) | 6,329,110.47 |
| Kapital i nenshkruar ne para (i pagueshem deri 11/2015) | | | 17,038.11 | 17,038.11 |
| Kapital i nenshkruar, por i papaguar | | | (17,038.11) | (17,038.11) |
| Zmadhim kapitali nga fitimi BOA 2014 | | | 36,766.99 | 36,766.99 |
| **Kapital Aksioner** | **5,716,520.86** | **924,523.36** | **(275,166.77)** | **6,365,877.45** |
| Primi i aksioneve | 2,045,041.37 | | | 2,045,041.37 |
| Primi i aksioneve nga procesi i bashkimit | | | 311,933.10 | 311,933.10 |
| **Primi I aksioneve** | **2,045,041.37** | | **311,933.10** | **2,356,974.47** |
| **Rezerva e përgjithshme** | **1,437,615.07** | **8,410.02** | | **1,446,025.09** |
| **Rez.rivler. të letrave me vlerë të vlefshme për shitje** | **44,190.58** | | | **44,190.58** |
| Fitime të pashpërndara | 1,458,248.87 | | | 1,458,248.87 |
| Zmadhim kapitali nga fitimi BOA 2014 | | | (36,766.99) | (36,766.99) |
| Fitimi i vitit ushtrimor | 423,058.12 | 47,436.22 | | 470,494.34 |
| **Fitime të pashpërndara** | **1,881,306.99** | **47,436.22** | **(36,766.99)** | **1,891,976.22** |

Sqarojmë se zëri i kapitalit aksioner (të nënshkruar) do të rritet me vlerën nominale të aksioneve të reja që do të emetohen. Diferenca mes vlerës nominale dhe vlerës kontabël ("cmimi i shitjes" në këtë rast) pasqyrohet në zërin prime nga aksionet.

- Të drejta dhe detyrimet e shoqërive kundrejt njëra-tjetrës shuhen në Bilancin e Celjes së Shoqërisë Përthithëse; të tilla janë depozitat dhe balancat e llogarive rrjedhëse të Credins Leasing pranë Bankës Credins (në vlerë totale prej 440,205,303.14 Lekë) , financimet që ka përfituar Credins Leasing nga Banka Credins (në vlerë totale prej 361,904,716 Lekë), kontrata qeraje financiare të përfituara nga Banka Credins dhe ofruara nga Credins Leasing (në vlerë të përgjithshme prej 1,114,916 Lekë) .

- Aktivet dhe detyrimet tatimore të shoqërisë Credins Leasing transferon tek shoqëria përthithëse. Më 30 Qershor 2015, shoqëria Credins Leasing ka balancë të TVSH kreditore dhe detyrime tatimore korrente sipas tabelës së mëposhtme:

| Aktive dhe Detyrime Tatimore - 30 Qershor 2015 | Credins Leasing sha |
|---|---|
| TVSH kreditore | 166,604,616 |
| **Total Aktive Tatimore (Lekë)** | **166,604,616** |
| Detyrime për Sigurime & tatim mbi te ardhurat personale | 501,626 |
| Detyrime Tatim fitimi | 1,101,479 |
| Detyrime Tatimi mbi vleren e shtuar | - |
| Detyrime për të tjera tatime ( tatim qeraje,15% tatim ne burim, tatim interes dep) | 150,608 |
| **Total Detyrime Tatimore (Lekë)** | **1,753,714** |

- Credins Leasing, si më 30.06.2015, ka një detyrim ndaj dy aksionerëve të saj Pandeli Garo dhe Renis Tërshana[1] në formën e borxhit nga aksionerët. Përshkak të karakteristikave të kontratave asnjë prej tyre nuk përbën borxh të varur sipas përshkrimeve të rregullores së mbikëqyrjes "Për Kapitalin Rregullator".

  Pas bashkimit këto detyrime do të transferohen tek banka Credins e cila në bazë të kushteve të kontratave dhe nevojave të saj mund të vendosë të mbajë ose shlyejë para kohe këto borxhe. Aksioneri Pandeli Garo më 30 Qershor 2015 rezulton me një detyrim prej 186,937.26 Euro ndaj shoqërisë Banka Credins Sh.A për një pjesë të aksioneve të nënshkruara prej tij por ende të papaguara. Pas bashkimit me përthithje, Banka Credins dhe aksioneri i saj Pandeli Garo mund të zgjedhin, me mirëkuptim, të bëjnë ose jo një kompension të drejtave dhe detyrimeve.

- Sjellim në vëmendje se në rastin e aplikimit të standardeve lokale të raportimit (atyre të Bankës së Shqipërisë) normat e provigjionimit që aplikohen mbi aktivitetin/portofolin leasing janë të ndryshme për subjektet banka dhe ato financiare jo-bankare. Për këtë arsye pas përthithjes, për qëllime të raportimeve sipas standardeve lokale (BoA) portofoli leasing do ti nënshtrohet provigjionimit të aplikueshëm nga banka (i cili është me norma më të larta se ato qe aplikohen momentalisht nga shoqeria leasing-ut). Më poshtë paraqiten normat e provigjoneve për secilen prej shoqerive:

| | Normat për fondet rezervë | |
|---|---|---|
| **Klasat** | **Banka Credins** | **Credins Leasing** |
| Standard (0-30 ditë) | >=1% | >=1% |
| Në ndjekje (31-90 ditë) | >=5% | >=5% |
| Nënstandarde (91-180 ditë) | >=20% | >=20% |
| Të dyshimta (181-365 ditë) | **>=50%** | **>=20%** |
| Të humbura (>365 ditë) | **100%** | **>=20%** |

  Sipas standardeve IFRS (sipas të cilave përgatitet konsolidimi), nuk do të ketë asnjë ndryshim në provigjionimin e portofoleve para dhe pas bashkimit.

- Të gjitha ndryshimet në pasqyrat financiare të shoqërive deri në datën e mbylljes të bashkimit me përthithje, të cilat sjellin ndryshimin e Bilancit të Celjes së shoqërisë përthithëse, do të raportohen e miratohen në asambletë e aksionerëve të të dy shoqërive.

- Lidhur me raportimet pranë Bankës së Shqipërisë, nuk do të ketë asnjë ndryshim të rëndësishmë pasi Banka Credins e ka qeranë financiare në listën e produkteve të saj. Qeraja financiare klasifikohet në

[1] Credins Leasing Sh.A ka paguar plotësisht detyrimin ndaj aksionerit Renis Tërshana më 03.08.2015.

klasën 2 të Aktivit, Veprime me Klientët. Me përthithjen e Credins Leasing, ky zë do të rritet, pra do rritet kredia në aktiv duke u rritur edhe fondi përkatës i provigjioneve. Në raportimet SRU, në formularët që prekin kredinë, pas bashkimit, do të pasqyrohet edhe portofoli i qerasë financiare. Nuk do të ketë asnjë ndryshim përsa i përket datave të raportimeve SRU.

## VIII. TË DREJTA TË VECANTA

Transferimi nuk prek të drejta të vecanta të aksionerëve. Të gjithë aksionerët e bankës Credins të cilët zotërojnë aksione të tipit A nuk do t'u preket asnjë e drejtë e vecantë dhe do të vazhdojnë të gezojnë të njëjtat të drejta edhe pas bashkimit me përthithje.

Aksionet e Credins Leasing Sh.A, sipas statutit të kësaj shoqërie janë të gjitha të llojit Aksione të Zakonshme. Të gjithë aksionet e zakonshme të Credins Leasing Sh.A do të këmbehen me aksione të zakonshme të bankës Credins. Të drejtat që do të rrjedhin nga këto aksione të zakonshme të bankës janë sipas parashikimeve të Statutit të Bankës.

## IX. KRIJIMI I KUSHTEVE PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE

Në mënyrë që të garantohet vijimësia e suksesshme e aktivitetit të leasingut brënda strukturës së bankës Credins, **para datës së ekzekutimit** (data e regjistrimit të marrëveshjes së bashkimit me përthithje në QKR) duhet të plotësohen dhe krijohen një sërë kushtesh të përshtatshme për ushtrimin e këtij aktiviteti :

### i. Sistemi i TI

Sistemi aktualisht në përdorim prej Bankës Credins nuk është i përshtatshëm për mbulimin e nevojave të aktivitetit të qerasë financiare. Për këtë arsye, pas bashkimit me përthithje, njësia e dedikuar që do të mbulojë aktivitetin e leasingut në bankë do të përdorë të njëjtin sistem (Charisma) që ka në përdorim shoqëria Credins Leasing Sh.A, para bashkimit. Pas bashkimit me përthithje do të shfrytëzohet infrastruktura TI e bankës. Perfshirja ne infrastrukturen e Bankës do të thotë që serverat dhe kompiuterat e Credins Leasing, do të përfshihen në operacionet e Departamentit të IT dhe do të jenë edhe ato subjekt mirëmbajtjeje dhe monitorimi. Përfshirja në infrastrukturën TI të Bankës do të sjellë edhe virtualizim të serverave, nëse vlerësohet e nevojshme, si dhe përfshirjen në strukturën e planit të rekuperimit të TI dhe Business Continuity Plan të Bankës. Specialisti i TI i cili ndjek programin Charisma pranë Credins Leasing, është i nevojshëm për vazhdimin e administrimit të programit edhe pas bashkimit.

Banka Credins, para datës së ekzekutimit së bashkimit, do të marrë të gjitha masat për vendosjen e marrëdhënies me shoqërinë që aktualisht i ofron shoqërisë Credins Leasing (para bashkimit) shërbimet e mirëmbajtjes së programit Charisma.

Sistemi i Bankës dhe sistemi i leasing-ut do të punojnë të pandërfaqur me njëri- tjetrin. Raportimet do të automatizohen pjesërisht dhe Departamenti i IT do të ofrojë mundësinë për ta realizuar këtë në bashkëpunim me specialistin IT për leasing.

Operacionet e mësipërme nuk cënojnë vazhdimësinë e punës në njësinë e Leasing. Opsioni i sipërpërmendur: (1) mundëson vazhdimin e punës pranë njësisë së leasing minimalisht në të njëjtin nivel me të tanishmin dhe siguron një nivel minimal të domosdoshëm integrimi me Bankën. Ky opsion është i realizueshëm menjëherë dhe me kosto të ulëta.

Zgjidhjet e mëposhtme nuk përbëjnë kushte paraprake për realizimin e bashkimit, por mund të konsiderohen në varësi të objektivave të Bankës lidhur me shtrirjen e aktivitetit të leasing.

- Në zbatim të planeve për zgjerimin e aktivitetit, pra nëse rrjeti i degëve të Bankës do të shfrytëzohet edhe nga leasing, lind nevoja e shtimit të numrit të userave. Licenca e përdorimit të programit Charisma, që gëzon Credins Leasing, është vetëm për 10 usera. Shtimi i aktivitetit do të sillte edhe nevojën e integrimit me programin e Bankës.

- Mundësi tjetër do të ishte ndryshimi i programit të leasing dhe zëvendësimi i tij me një program tjetër të integruar paraprakisht me programin e Bankës. Kjo zgjidhje kërkon vlerësim edhe të situatës aktuale, performancës së sistemit, madhësisë së databazës, përmbushjes së kërkesave aktuale të biznesit nga programi, etj.

### ii. Organigrama e Re

Deri në datën e ekzekutimit të bashkimit, strukturat përgjegjëse për rregullimin e funksioneve në Bankë në bashkëpunim me menaxhmentin e Bankës dhe Credins Leasing do të krijojnë një njësi të dedikuar për aktivitetin e leasingut në organigramë (Departament/Drejtori). Do të hartohen përshkrimet e punës dhe përgjegjësive të personave me të drejta dhe përgjegjësi të vecanta, sipas parashikimeve të nenit 20, pika f) e rregullores së BSH "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë".

### iii. Plani i Biznesit dhe Pritshmëritë Ekonomike

Menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes dhe para ekzekutimit të bashkimit do të hartohet një plan biznesi i cili do të shpjegojë se si do të funksionojë leasingu në bankë, cilat do të jenë planet lidhur me këtë aktivitet, stafin, marketimin e produktit etj. Do të hartohen projeksionet financiare të Bankës pas transaksionit të bashkimit duke konsideruar efektin sinergjik si dhe impaktin pozitiv të padiskutueshëm të disponibilitetit të fondeve dhe rrjetit të gjerë të shitjes tek aktiviteti i leasingut.

### iv. Statuti i Ndryshuar

Para datës së regjistrimit të bashkimit në QKR, Departamenti Ligjor të bëjë të gjitha ndryshimet e nevojshme në statutin e bankës për ta përshatur më ndryshimet dhe për të qënë i vlefshëm për shoqërinë përthithëse.

v. **Njoftimi dhe/ose Marrja e Pëlqimit nga Palë të Treta**

Para datës së regjistrimit të bashkimit në QKR, Banka Credins dhe Credins Leasing do të njoftojnë palët e treta për transaksionin e bashkimit nëse dicka e tillë është e parashikuar në kontratat në fuqi me këto palë.

Banka Credins ka këto detyrime kontraktuale për njoftimin e palëve të treta mbi transaksionin e bashkimit:

1. Sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Huasë ("Loan Agreement", datë 7 Mars 2013) mes Bankës Credins dhe International Finance Corporation (**IFC**), Banka Credins ka detyrimin të njoftojë IFC për realizimin e bashkimit me përthihtje.

2. Sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Huasë ("Loan Agreement", datë 28 Gusht 2013) mes Bankës Credins dhe European Bank for Reconstruction and Development (**EBRD**), Banka Credins ka detyrimin të njoftojë EBRD për realizimin e bashkimit me përthihtje.

Credins Leasing ka këto detyrime kontraktuale për njoftimin e palëve të treta mbi transaksionin e bashkimit:

1. Sipas parashikimeve të Marrëveshjes së Huasë ("Loan Agreement") mes Credins Leasing dhe European Bank for Reconstruction and Development (**EBRD**), Credins Lrasing ka detyrimin të njoftojë EBRD për realizimin e bashkimit me përthihtje.

Përvec detyrimeve të mësipërme kontraktuale, palët kanë detyrim ligjor të njoftojnë **organet tatimore**, të marrin miratimin paraprak nga **Banka e Shqipërisë** si dhe autorizimin e **Autoritetit të Konkurrencës**.

## X. EFEKTET MBI PUNËMARRËSIT

Në datën e regjistrimit të bashkimit në QKR, të gjitha kontratat e punës së punëmarrësve të Credins Leasing në fuqi do të transferohen pranë Bankës Credins, në përputhje me Nenin 138 dhe 139 të Kodit të Punës. Banka Credins do të marrë përsipër të gjithë kontratat e punës të punëmarrësve të Credins Leasing dhe do të konsiderohet pala përgjegjëse për cdo detyrim të pashlyer nga Credins Leasing para datës së ekzekutimit.

## XI. EFEKTE MBI ORGANET DREJTUESE TË BANKËS CREDINS PAS PËRTHITHJES

Bashkimi me përthithje nuk do të sjellë asnjë ndryshim në organet drejtuese të Bankës Credins. Në datën e ekzekutimit të bashkimit, anëtarët e organeve drejtuese të bankës Credins do të konsiderohen anëtarët e organeve të shoqërisë përthithëse. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe organeve të tjera të Credins Leasing do të japin dorëheqjen në Datën së Ekzekutimit.

## XII. EFEKTET LIGJORE TË BASHKIMIT

Sikurse parashikon neni 220, pika 3, e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", regjistrimi i bashkimit të shoqërive pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit:

a) ka pasojë kalimin te shoqëria përthithëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që përthithet.Ky transferim ka pasoja si në marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, ashtu edhe te palët e treta;

b) bën që aksionarët e shoqërisë së përthithur të bëhen aksionarë të shoqërisë përthithëse;

c) bën që shoqëria që përthithet të vlerësohet e prishur, ndaj çregjistrohet nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, pa kaluar në procesin e likuidimit. Personalitet juridik do të vazhdojë të ketë vetëm shoqëria përthithëse Banka Credins Sh.A,.

## XIII. LISTA E ANEKSEVE

- Aneks 1. Vendimet e Asambleve të Përgjithshme të Aksionerëve të shoqërive Banka Credins Sh.A dhe Credins Leasing Sh.A.
- Aneks 2 Pasqyra e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të Credins Leasing Sh.A.
- Aneks 3 Pasqyra e Pozicionit Financiar të Datës së Fundit Kontabël të Banka Credins Sh.A.
- Aneks 4 Bilanci i Çeljes dhe Shënimet Shpjeguese

---

Ky raport përgatitet nga përfaqësuesit ligjorë të shoqërive Banka Credins dhe Credins Leasing në vijim të autorizimit nga Asambletë e Aksionerëve të shoqërive përkatëse :

| BANKA CREDINS SH.A | CREDINS LEASING SH.A. |
|---|---|
| Përfaqësues Ligjor | Përfaqësues Ligjor |
| Maltin KORKUTI | Elion MARTINI |

CREDINS bank
ZYRA QENDRORE | 212-00
TIRANË –SHQIPËRI

CREDINS leasing
NIPT: K11717006G
Rr. Nikolla Tupe, Nr.5, Tirana, Albania

